

REPUBLICA E KOSOVËS
Republic of Kosovo
AKADEMIA E SHKENCAVE
DHE E ARTEVE E KOSOVËS
Kosovo Academy of
Sciences and Arts

Nr.: 404
Fq: 3
Dt: 24.03.2026

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
ZYRA E KRYPËMINISTRI - ZEDER PREMIJERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
INSTITUTI I KRIMEVE TË KRYERA GJATË LUFTËS NË KOSOVË

Dalëse

Nr. / Br. / No. 01/202
Nr. i faq. / Br. str. / No. pg. 3
Data/Datum/Date 24 / 03 / 2026

Pristinë : Prishtina : Pristina



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

për Bashkëpunim Institucional

ndërmjet

AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE ARTEVE TË KOSOVËS (ASHAK)

dhe

**INSTITUTI I KRIMEVE TË KRYERA GJATË LUFTËS NË KOSOVË
(IKKL)**

Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (AShAK) dhe Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL), në vijim: Palët,

Duke u mbështetur në Statutin në fuqi të ASHAK, në veçanti:– nenin 3, që përcakton misionin dhe veprimtarinë themelore të ASHAK si institucioni më i lartë shkencor dhe artistik i Republikës së Kosovës; nenin 29, pika 1, nën paragrafi 6, për vendosjen e bashkëpunimeve institucionale dhe memorandumeve; nenin 35, për kompetencat ekzekutive të Kryetares së ASHAK për nënshkrimin e akteve dhe marrëveshjeve;

Duke marrë parasysh misionin ligjor dhe institucional të IKKL për dokumentimin, hulumtimin dhe analizimin e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare;

Duke theksuar rëndësinë e qasjes multidisiplinare dhe respektimit të standardeve të së drejtës ndërkombëtare, metodologjisë shkencore dhe etikës akademike;

Palët bien dakord për këtë Memorandum Mirëkuptimi si vijon:

Neni 1 – Qëllimi dhe Objektivat

1. Qëllimi i Memorandumit është vendosja e një kornize të qëndrueshme dhe afatgjatë të bashkëpunimit institucional ndërmjet Palëve.
2. Objektivat kryesore:
 - a) Zhvillimi i kërkimeve shkencore mbi krimet e luftës në Kosovë;
 - b) Dokumentimi, sistemimi dhe analizimi i burimeve arkivore dhe dëshmive relevante;
 - c) Avancimi i debatit shkencor dhe akademik mbi drejtësinë tranzicionale;
 - d) Ruajtja e kujtesës historike dhe kundërshtimi i tendencave për relativizim dhe rishkrim të historisë.

Neni 2 – Fushat dhe Format e Bashkëpunimit

Bashkëpunimi do të realizohet në këto forma:

- Shkëmbimi dhe përdorimi i literaturës shkencore, arkivave, databazave dhe dokumentacionit;
- Organizimi i përbashkët i konferencave, simpoziumeve, tryezave të rrumbullakëta dhe debateve akademike;
- Realizimi i projekteve të përbashkëta kërkimore dhe studimore;
- Botimi i monografive, përmbledhjeve dhe publikimeve të tjera shkencore;
- Angazhimi i akademikëve, studiuesve dhe ekspertëve të Palëve si autorë, recensentë dhe këshilltarë;
- Bashkëpunimi në aplikime për projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Organizimi i trajnimeve, ligjëratave dhe aktiviteteve edukative me karakter shkencor.

Neni 3 – Parimet Themelore

Bashkëpunimi do të bazohet në:

- Pavarësinë dhe autonominë institucionale;
- Barazinë dhe respektin reciprok;
- Objektivitetin dhe rigorozitetin shkencor;
- Respektimin e etikës akademike dhe të së drejtës ndërkombëtare;
- Transparencën dhe përgjegjësinë institucionale.

Neni 4 – Koordinimi Institucional

1. Akademik Arsim Bajrami caktohet koordinator institucional nga ASHAK për zbatimin e Memorandumit.
2. IKKL cakton përfaqësuesin e tij përgjegjës për koordinim.
3. Palët mund të themelojnë grupe të përbashkëta pune për aktivitete specifike.

Neni 5 – Aspektet Financiare dhe Administrative

1. Memorandumi nuk krijon obligime financiare automatike.
2. Aktivitetet që kërkojnë mjete financiare do të rregullohen me marrëveshje të veçanta.
3. Palët mund të kërkojnë mbështetje financiare nga burime të treta, në përputhje me ligjin.

Neni 6 – Kohëzgjatja

Memorandumi lidhet për pesë (5) vjet, me mundësi rinovimi me pëlqim të ndërsjellë.

Neni 7 – Dispozita Përfundimtare

Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe nënshkruhet në dy kopje origjinale.

Në Prishtinë më 24 / 03 / 2026

Kryetare e ASHAK

Akademike Justina Shiroka -Pula

Drejtori i IKKL

Z. Atdhe Hetemi